



Qeveria synon paga dhe kushte dinjitoze për ushtarakët, drejt standardeve të NATO-s

» faqe 3



ZËVENDËSMINISTRJA E MBROJTJES, ZNJ. BLERINA ABRAZHDA, "GUEST SPEAKER" NË KLSM-16

Në kuadër të programit akademik të Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16), pjesëmarrësit patën nderin të ndiqnin një leksion të mbajtur nga Zëvendësmministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, në cilësinë e "Guest Speaker". Analizë mbi rreshtimin gjeopolitik. Gjatë fjalës së saj, znj. Abrazhda trajtoi temën "Rreshtimi gjeopolitik i shteteve", duke ofruar një analizë mbi: rëndësinë e orientimit strategjik të shteteve; ndikimin në stabilitetin rajonal dhe rolin...

faqe 2



NUREDIN GORÇE, YLLI I PASHUAR I DETYRËS DHE NDERIT USHTARAK

Në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare ka emra që nuk zbehen me kalimin e viteve, por përkundrazi ndriçojnë më fort në ndërgjegjen kombëtare. Një ndër ta është edhe Nuredin Gorçe, Kapiten i Parë dhe një nga figurat më përfaqësuese të sakrificës në krye të detyrës. Motoja e përgjeshme "Kush bie për atdhe, mbetet një yll i pashuar" mishërohet plotësisht në jetën dhe rënien heroike të tij. Në përvjetorin e rënies, kujtesa jonë kolektive rikthehet...

faqe 10



26 VITE NË VIJËN E HOLLË MES JETËS DHE VDEKJES: MISIONI FISNIK I SPECIALISTËVE EOD NË FORCAT E ARMATOSURA

Më 19 mars 1999, në një kohë sfidash të mëdha për sigurinë dhe stabilitetin në rajon, në radhët e Forcave të Armatosura shqiptare mori jetë një strukturë elitare, e ndërtuar mbi guximin, profesionalizmin dhe përkushtimin absolut ndaj detyrës: njësia e Asgjësimit të Municioneve të Pashpërthyer EOD (Explosive Ordnance Disposal). Ishte një grup i përzgjedhur me kujdes, ku u thirrën më të mirët e më të mirëve, burra dhe gra...

faqe 7

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi zhvilloi takim me Atashetë Ushtarakë të akredituar në Shqipëri

Ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, zhvilloi një takim prezantues me Atashetë Ushtarakë të akredituar në Shqipëri, në një atmosferë bashkëpunimi dhe shkëmbimi idesh mbi sfidat e sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Bashkëpunimi si themel i sigurisë së përbashkët

Gjatë takimit, ministri Nufi theksoi rëndësinë e partneritetit të ngushtë me shtetet aleate dhe partnerët strategjikë:

“Në një kohë kur sfidat e sigurisë janë gjithnjë e më komplekse dhe të ndërthurura, bashkëpunimi ynë mbetet themeli i sigurisë së përbashkët”, – deklaroi ministri Nufi.

Përkushtim për forcimin e partneriteteve

Ministria e Mbrojtjes konfirmoi angazhimin e saj për të thelluar marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë dhe për të siguruar që Shqipëria të vazhdojë të jetë një aleat i besueshëm, modern dhe i qëndrueshëm në kuadër të strukturave të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Ky takim nënvizon rëndësinë që Forcat e Armatosura shqiptare i kushtojnë bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rolit aktiv në sigurimin e stabilitetit dhe gatishmërisë operationale.



Zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrabhda, “Guest Speaker” në KLSM-16

Në kuadër të programit akademik të Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16), pjesëmarrësit patën nderin të ndiqnin një leksion të mbajtur nga Zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrabhda, në cilësinë e “Guest Speaker”.

Analizë mbi rreshtimin gjeopolitik

Gjatë fjalës së saj, znj. Abrabhda trajtoi temën “Rreshtimi gjeopolitik i shteteve”, duke ofruar një analizë mbi rëndësinë e orientimit strategjik të shteteve; ndikimin në stabilitetin rajonal dhe rolin në arkitekturën globale të sigurisë.

Aktiviteti u ndoq edhe nga gjeneral brigade Altin Kurti, i cili vlerësoi rëndësinë e trajtimit të temave gjeopolitike në përgatitjen akademike dhe profesionale të kursantëve.

Vlerësim për kontributin akademik

Leksioni u vlerësua nga pjesëmarrësit si një kontribut i rëndësishëm në kuptimin e zhvillimeve bashkëkohore dhe sfidave që ato paraqesin për sigurinë ndërkombëtare.

Ky aktivitet dëshmon angazhimin e institucioneve të mbrojtjes për të forcuar kapacitetet profesionale të personelit, në përputhje me standardet e NATO-s dhe kërkesat e mjedisit bashkëkohor të sigurisë.



Takim bashkëpunimi mes Kolegjit të Mbrojtjes e Sigurisë dhe Atasheut Ushtarak të Francës

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, zhvilloi një takim pune me Atasheun Ushtarak të Francës rezident në Tiranë, kolonel Valery Sens.

Fokus në programet akademike dhe lidershipin

Në qendër të bisedës ishin programet akademike të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, me theks të veçantë te: Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) dhe Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM).

Këto programe u vlerësuan si shtylla kyçe në përgatitjen e lidershipit ushtarak dhe civil, në përputhje me kërkesat e mjedisit bashkëkohor të sigurisë.

Thellim i bashkëpunimit me palën franceze

Gjatë takimit, pala franceze vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet e mbrojtjes shqiptare dhe shprehu gatishmërinë për ta forcuar më tej këtë bashkëpunim.

Në këtë kuadër, u theksua rëndësia e shkëmbimeve akademike, zhvillimit të praktikave të përbashkëta dhe harmonizimit të programeve mësimore, me synim rritjen e standardeve profesionale dhe përafrimin me modelin më të avancuar ndërkombëtar.

Angazhim për zhvillim dhe standarde të larta

Takimi konfirmoi angazhimin e ndërsjellë për zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit ushtarak dhe të sigurisë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së përgatitjes së personelit dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale.

Qeveria synon paga dhe kushte dinjitoze për ushtarakët, drejt standardeve të NATO-s

Qeveria e Republikës së Shqipërisë miratoi një vendim të rëndësishëm që synon përmirësimin e kushteve financiare për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, përkatësisht në fushën e kompensimit të transportit.

Gjatë prezantimit para medias, **ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi**, theksoi se ky vendim është një hap domethënës drejt përmirësimit të kuadrit ekzistues të trajtimit financiar të ushtarakëve dhe përputhjes me standardet e institucioneve të tjera ligj zbatuese si policia.

“Sot miratuam një VKM që lidhet me përcaktimin e kriterëve dhe masave të kompensimit të transportit të ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura. Ky vendim vjen si domosdoshmëri për përshtatjen e legjislacionit në fushën e mbrojtjes në përputhje edhe me forca të tjera siç janë policia apo organe të tjera ligj zbatuese”, - deklaroi ministri Nufi.

Ai nënvizoi se zbatimi i këtij vendimi do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të shërbimit, veçanërisht për ushtarakët që shërbejnë në misione jashtë vendit. “Në zbatim të tij, ky vendim përkthehet në kushte më dinjitoze për ushtarakët tanë, veçanërisht për ushtarakët që na përfaqësojnë në misione të huaja”, shtoi ministri.

Ministri Nufi gjithashtu bëri të ditur se sektori i Forcave të Armatosura ka shënuar rritjen më të lartë të pagave në vend, sipas të dhënave të fundit të INSTAT për vitin 2025, ku është regjistruar një rritje prej **10.6%**.

Duke theksuar synimet afatgjata, ministri njoftoi se qeveria synon që deri në vitin **2029** të arrijë nivele pagash të krahasueshme me mesataren e vendeve anëtare të **NATO-s**, përmes një rritjeje prej **60–70%** për nivelin bazë dhe **30–40%** për nivelet e larta të komandimit.

“Me këtë projektvendim, afrohemi drejt objektivit tonë që deri në vitin 2029 të arrijmë nivelin mesatar të vendeve anëtare të NATO-s”, - tha ministri Nufi.

Ministri përmendi gjithashtu se Shqipëria renditet ndër vendet me paga mesatare më të larta në rajon për sektorin e Forcave të Armatosura.



Qeveria synon që deri në vitin 2029 të arrijë nivele pagash të krahasueshme me mesataren e vendeve anëtare të NATO-s, përmes një rritjeje prej 60–70% për nivelin bazë dhe 30–40% për nivelet e larta të komandimit.

Ministri i Mbrojtjes z. Ermal Nufi zhvilloi një vizitë pune në Komandën e Forcës Tokësore në Zall-Herr, ku u njoh nga afër me aktivitetin, përgatitjen dhe kapacitetet operacionale të kësaj force, e konsideruar si shtylla kurrizore e Forcave të Armatosura.

Gjatë vizitës, ministri u prit nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Petrit Çuni, i cili prezantoi përditshmërinë e efektivëve, sfidat me të cilat përballen si dhe prioritetet kryesore të zhvillimit të forcës.

Fokus në reforma dhe kapacitete operacionale

Në takimet me drejtues të lartë dhe efektivë të Forcës Tokësore u paraqitën objektivat kryesore dhe funksionimi i strukturave përbërëse të saj.

Ministri zhvilloi gjithashtu një takim të veçantë me shtabin dhe drejtuesit e forcës, ku u diskutua për vijimin e reformave dhe rritjen e kapaciteteve operacionale, në përputhje me standardet e NATO-s dhe kërkesat e mjedisit të sigurisë.

Inspektim në terren dhe kapacitete stërvitore

Gjatë vizitës, ministri i Mbrojtjes Nufi inspektoi nga

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi inspekton Forcën Tokësore në Zall-Herr



afër ambientet e Qendrës Taktike, rajonin stërvitor MADM, Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë të vendosura në Komandën e Zall-Herrit, ku u njoh me nivelin teknik dhe përgatitjen e trupave në terren.

Modernizim dhe pajisje bashkëkohore

Në kuadër të investimeve të fundit në Forcat e

Armatosura, ministri u njoh edhe me lloje të ndryshme armatimesh, ndër të cilat spikat sistemi raketor kundërtank “Javelin”, i dorëzuar së fundmi Forcës Tokësore në kuadër të bashkëpunimit ushtarak me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjatë bashkëbisedimit me drejtuesit dhe efektivët, ministri theksoi rëndësinë e përkushtimit ndaj uniformës dhe standardeve profesionale: “Është shumë e rëndësishme që njerëzit ta duan uniformën dhe kur shikon një standard të tillë, na bën të ndihemi krenarë për nivelet teknike që kanë arritur Forcat e Armatosura shqiptare”.

Angazhim për forcim të mëtejshëm të FA-ve

Vizita u mbyll me theksin mbi angazhimin për vijimin e reformave dhe modernizimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura, me synim rritjen e gatishmërisë dhe përmeshjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s.

Në Shkollën e Trupës së Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit **“Junior Command and Leadership Course (JCLC)”**, i cili u realizua gjatë katër javëve intensive trajnuese.

Në këtë kurs morën pjesë 33 kursantë të Kursit Bazë të Oficerit, specialiteti këmbësori, nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, të cilët përfituan njohuri dhe aftësi në drejtim, vendimmarrje dhe lidhshmëri në nivel taktik.



Trajnim sipas standardeve ndërkombëtare

Programi i trajnimit u udhëhoq nga instruktorët e Shkollës së Trupës së Forcës Tokësore, në bashkëpunim të ngushtë me instruktorët e British Military Advisory Training Team (BMATT). Ky bashkëpunim solli në fokus përvojën dhe standardet më të mira ndërkombëtare, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen profesionale dhe përgatitjen e kursantëve për sfidat e terrenit.

Pjesëmarrje e gjerë institucionale

Në ceremoninë përmbyllëse morën pjesë personalitete të larta vendase dhe ndërkombëtare, ndër të cilët:

- Zëvendësministri i Mbrojtjes
- Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar
- Ambasadori i Republikës Çeke
- Atasheu Ushtarak Britanik
- Shefi i Shtabit të BMATT
- Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm
- Zv/Komandantja e Forcës Tokësore

Investim në liderët e së ardhmes

Kursi “JCLC” përfaqëson një hap të rëndësishëm në formimin e liderëve të rinj ushtarakë, duke forcuar aftësitë e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse në nivel taktik. Ky trajnim kontribuon drejtpërdrejt në: rritjen e kapaciteteve drejtuese, përmirësimin e gatishmërisë operacionale, përafrimin me standardet e NATO-s



Përfundon me sukses kursi “Junior Command and Leadership Course (JCLC)” në Forcën Tokësore



Angazhim për profesionalizëm dhe zhvillim

Përfundimi me sukses i këtij kursi dëshmon angazhimin e Forcave të Armatosura për të investuar në zhvillimin profesional të personelit dhe për të përgatitur një brez të ri liderësh, të aftë për të përballuar sfidat e mjedisit bashkëkohor të siguri.

Forca Ajrore e Shqipërisë (FAj) mori pjesë në stërvitjen shumëkombëshe ajrore “INIOCHOS 2026”, e zhvilluar në Bazën Ajrore Andravida, në Greqi, për një periudhë dyjavore, nën drejtimin e Forcës Ajrore greke.

Në këtë aktivitet ndërkombëtar u angazhuan disa vende aleate dhe partnere, ndër të cilat Franca, Sllovenia dhe Shqipëria me mjete ajrore, ndërsa Polonia mori pjesë me Forcat Speciale. Gjithashtu, Gjeorgjia, Serbia, Kroacia dhe India u përfaqësuan me ekepe vëzhguesish.



Kontribut operacional dhe përfaqësim dinjitoz

Forca Ajrore shqiptare u përfaqësua në këtë stërvitje me: një helikopter tip “Cougar”, një automjet taktik “Land Rover”, një personel prej 11 efektivësh

Ekipi përbëhej nga pilotë, teknikë, mekanikë dhe operatorë bordin, të cilët demonstruan profesionalizëm dhe gatishmëri të lartë gjatë gjithë aktivitetit.

Misione në përputhje me standardet e NATO-s

Gjatë fazës së ekzekutimit, ekuipazhi i Faj-së realizoi:

- **5 misione fluturimi për transport trupash**
- **me një kohë totale prej 10 orë e 10 minuta fluturim**

- **si dhe 2 misione rikonjicioni**

Misionet e transportit u zhvilluan në bashkëpunim të ngushtë me Forcat Speciale polake, duke përfshirë skenarë **infiltrim/exfiltrim** dhe **CASEVAC**, në përputhje të plotë me standardet dhe procedurat e NATO-s.

Stërvitje, analizë dhe mirëmbajtje teknike

Pas çdo fluturimi, u kryen inspektime teknike sipas kërkesave të mirëmbajtjes, duke garantuar sigurinë dhe



FAj, pjesë e stërvitjes shumëkombëshe ajrore “INIOCHOS 2026”



funksionalitetin e mjeteve ajrore.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit ishin gjithashtu:

- briefingjet operative
- planifikimi i misionëve
- analizat pas veprimit (After Action Review)

Këto procese kontribuan në rritjen e efektivitetit operacional dhe përmirësimin e performancës së ekuipazhit.

Rritje e ndërveprueshmërisë dhe gatishmërisë

Pjesëmarrja në stërvitjen “INIOCHOS 2026” kontribuon



drejtpërdrejt në rritjen e ndërveprueshmërisë me forcat ajrore aleate dhe mbështet implementimin e objektivit të NATO-s për “gatishmërinë e dislokimit të kapaciteteve ajrore”.

Kjo pjesëmarrje konfirmon nivelin e lartë të përgatitjes profesionale të Forcës Ajrore shqiptare dhe aftësinë e saj për të operuar në mjedis shumëkombëshe, duke forcuar më tej kapacitetet operacionale dhe integrimin në operacionet ajrore të Aleancës.



ANJEZA MUSOLLARI, Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një nga ato bisedat e zakonshme mes miqsh, ku koha rrjedh pa u ndjerë dhe temat kalojnë natyrshëm nga e përditshmja tek shqetësimet më të thella, u ndalëm te një çështje që duket se prek gjithnjë e më shumë realitetin shqiptar, puna dhe ndarja e heshtur mes profesionalizmit dhe mbijetesës ekonomike. Diskutuam gjatë për një kategori njerëzish që e shohin punën jo si një mundësi për rritje, angazhim dhe zhvillim personal, por thjesht si një burim të ardhurash, një detyrim që duhet përmbushur me minimumin e mundshëm të përkushtimit.

Ishte një bisedë e ngarkuar me reflektim, por edhe me një lloj zhgënjimi të përbashkët. Dhe pikërisht në atë moment, një miku im artist me vite të arta karriere, një njeri që e ka jetuar punën si pasion dhe si mision, ndërhyri me një qetësi që e bëri fjalën e tij edhe më të rëndë. Ai thjesht tha: *“Po të ishte puna e mirë, edhe prifti do ta donte.”*

Në dukje, një shprehje e njohur, e thënë shpesh me humor në tryeza shqiptare. Por në atë kontekst, ajo nuk tingëlloi si batutë. Përkundrazi, ra si një e vërtetë e hidhur që na la për disa çaste në heshtje. Sepse brenda saj fshihej jo vetëm një perceptim i rrënjosur për punën, por edhe një dorëzim i nënkuptuar përballë një realiteti që duket i vështirë për t'u ndryshuar.

Më erdhi keq jo thjesht për fjalinë në vetvete, por për faktin që ajo pasqyronte një ndjenjë të përhapur, që puna në vend që të jetë burim dinjiteti dhe zhvillimi, shpesh shihet si barrë, që përkushtimi nuk shpërblehet gjithmonë dhe që idealizmi, në shumë raste, zëvendësohet nga pragmatizmi i ftohtë. Dhe ndoshta pikërisht këtu nis reflektimi i vërtetë: *a është kjo një e vërtetë që duhet pranuar, apo një mentalitet që duhet sfiduar?*

Një filozofi që ul pritshmëritë

Në thelb, kjo shprehje sugjeron një ide të thjeshtë, nëse puna do të ishte e mirë, të gjithë do ta donin. Pra, fakti që është e vështirë, e lodhshme apo e pakëndshme është diçka normale, madje e pashmangshme. Deri këtu, mund të duket si një vëzhgim realist. Por kur kjo ide shndërrohet në justifikim për të mos u përpjekur, ajo bëhet pengesë.

Në shoqërinë shqiptare, kjo filozofi shpesh shoqërohet me një qëndrim të nënkuptuar: *“Bëj aq sa të kalosh, jo aq sa të dallohesh”*. Është një mentalitet që nuk e nxit ekselencën, por e toleron mediokritetin. Dhe kur kjo bëhet normë, pasojat janë të dukshme në çdo sektor nga arsimi te administrata, nga biznesi te jeta publike.

Nga shprehje popullore në kulturë kolektive

Problemi nuk qëndron tek fjalja në vetvete, por tek mënyra si ajo është përvetësuar. Ajo është bërë pjesë e një kulture ku puna shihet si barrë, jo si mundësi, suksesi shihet me dyshim, jo me respekt, përpjekja e vazhdueshme shihet si naivitet, jo si vlerë.

Në këtë kontekst, individi që punon më shumë shpesh nuk admirohet, por paragjykohet. Pyetja që shtrohet nuk është “Si e arriti?”, por “Çfarë ka pasur pas shpine?”. Kjo krijon një klimë ku motivimi bie dhe cinizmi rritet.

Realiteti i vitit 2026: ndryshim në formë, jo në thelb

Në Shqipërinë e sotme, shumë gjëra kanë ndryshuar. Tregu i punës është më dinamik, mundësitë janë më të shumta, dhe ndikimi i jashtëm është më i fortë se kurrë. Por mentaliteti i përshkruar nga kjo shprehje vazhdon të jetë i pranishëm.

Në vend që puna të shihet si rrugë për zhvillim personal dhe profesional, ajo shpesh trajtohet si një detyrim që

“Po të ishte puna e mirë, edhe prifti do ta donte”



duhet përballuar me sa më pak përpjekje. Kjo nuk është thjesht çështje individuale, është një problem kulturor që ndikon në mënyrën si funksionon e gjithë shoqëria. Sepse një shoqëri që nuk e vlerëson punën, vështirë se mund të ndërtojë qëndrueshmëri. Një ekonomi që nuk mbështetet mbi përkushtimin, mbetet e brishtë. Dhe një sistem që toleron minimumin, rrallë arrin maksimumin.

Paradoksi shqiptar: duam suksesin, por shmangim rrugën drejt tij

Një nga kontradiktat më të mëdha që vërehet sot është se dëshira për sukses është e madhe, por gatishmëria për sakrificë është e kufizuar. Të gjithë duan të arrijnë, por jo të gjithë janë të gatshëm të përballen me vështirësitë që sjell rruga drejt arritjes. “Po të ishte puna e mirë...”, bëhet një alibi e rehatshme. Ajo e zhvendos përgjegjësinë nga individi tek natyra e punës. Nuk është se nuk po përpiqem është se puna nuk ia vlen. Nuk është se nuk jam i përkushtuar por kushtet janë të vështira.

Por historia e çdo shoqërie që ka përparuar tregon të kundërtën, përparimi nuk vjen nga shmangia e vështirësive, por nga përballja me to.

Roli i edukimit dhe shembullit

Ndryshimi i këtij mentaliteti nuk është i lehtë, sepse ai është i rrënjosur thellë në mënyrën si rriten dhe edukohen individët. Që në moshë të hershme, shpesh transmetohet ideja se puna është diçka që duhet “mbaruar”, jo diçka që duhet bërë mirë.

Prandaj, roli i familjes, shkollës dhe shoqërisë është thelbësor. Nëse fëmijët rriten duke parë se përpjekja shpërblehet dhe se puna vlerësohet, ata kanë më shumë gjasa të zhvillojnë një raport të shëndetshëm me të. Nëse përkundrazi, shohin që rrugët e shkurtra shpesh

funksionojnë, atëherë mesazhi që marrin është i qartë: përpjekja nuk është e domosdoshme.

Një apel për të ndryshuar narrativën

Shprehjet popullore nuk janë të pandryshueshme. Ato pasqyrojnë një realitet, por edhe mund të ndikojnë në të. Prandaj, është e rëndësishme të reflektojmë mbi mesazhet që përcjellim dhe mbi mënyrën si i interpretojmë ato.

Ndoshta është koha që kjo shprehje të mos përdoret më si justifikim, por si sfidë. Jo për të thënë se puna është e keqe, por për të pranuar se vlera e saj qëndron pikërisht në vështirësinë që mbart. Sepse ajo që kërkon përpjekje është ajo që ndërton karakter, aftësi dhe qëndrueshmëri.

Nga justifikimi tek përgjegjësia

“Po të ishte puna e mirë, edhe prifti do ta donte” mund të mbetet një shprehje me humor, por nuk duhet të mbetet një filozofi jetese. Sepse në momentin që e pranojmë si të tillë, ne heqim dorë nga një pjesë e përgjegjësisë sonë.

Në Shqipërinë e vitit 2026, sfida nuk është vetëm të krijohen më shumë vende pune, por të ndërtohet një kulturë që e respekton dhe e vlerëson punën. Një kulturë ku përpjekja nuk shihet si barrë, por si investim. Ku suksesi nuk shihet me dyshim, por si rezultat i meritës.

Sepse në fund të fundit, puna mund të mos jetë gjithmonë “e mirë” në kuptimin e lehtësisë. Por është e vetmja rrugë që e bën një shoqëri më të fortë, më të drejtë dhe më të zhvilluar.

Dhe ndoshta, dita kur do të ndryshojë kjo mënyrë e të menduarit, do të jetë edhe dita kur kjo shprehje do të humbasë kuptimin e saj, jo sepse është harruar, por sepse është tejkaluar.

NJË JETË E SHUAR, një shoqëri në provë: Kur dhuna vret dhe heshtja bashkëpunon



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kur titulli bëhet rutinë: Një shoqëri përballë dështimit të saj më të madh

Sot në mëngjes, titujt e portaleve dhe mediave shqiptare u mbushën sërish me një lajm që nuk duhej të ishte kurrë “lajm”: një grua 25-vjeçare i dha fund jetës së saj. Arsyeja? Dhuna e vazhdueshme nga bashkëshorti dhe familjarët e tij. Një fjalë e shkurtër, e ftohtë, e konsumuar nga përsëritja. Por pas saj fshihet një histori e gjatë dhimbjeje, heshtjeje dhe dështimi kolektiv.

Nuk është hera e parë. Dhe pikërisht ky është problemi më i madh.

Një tragjedi që nuk na trondit më sa duhet

Kur një shoqëri fillon të mësohet me tragjedi të tilla, rreziku nuk është vetëm dhuna në vetvete, por normalizimi i saj. Lajmi kalon nga një portal tek tjetri, shpërndahet në rrjete sociale, komentohet për disa orë dhe më pas zëvendësohet nga diçka tjetër.

Ndërkohë, një jetë është shuar, një familje është shkatërruar dhe një tjetër dështim i madh i shoqërisë është shtuar në heshtje në listën e gjatë të rasteve të ngjashme.

Ajo që e bën edhe më të rëndë këtë ngjarje është moshja: 25 vjeç. Një moshë që duhej të ishte e mbushur me plane, shpresa dhe fillime të reja. Në vend të kësaj, ajo u kthye në fundin e një rruge pa dalje, ku dhuna fizike dhe psikologjike e mbyllën çdo mundësi tjetër.

Dhuna që nuk fillon me goditjen e parë

Shpesh, kur flitet për dhunën, fokusi vendoset tek akti fizik. Por realiteti është shumë më kompleks. Dhuna fillon shumë më herët me kontrollin, me poshtërimin, me izolimin, me frikën që ndërtohet gradualisht. Është një proces që e dobëson viktimën dita-ditës, derisa ajo humbet jo vetëm sigurinë, por edhe besimin se mund të shpëtojë.

Në shumë raste, kjo dhunë ndodh brenda katër mureve të një shtëpie që nga jashtë duket “normale”. Dhe pikërisht kjo e bën edhe më të rrezikshme: është e fshehur, e padukshme për shumicën, por e pamëshirshme për atë që e përjeton.

Roli i familjes: Kur mbështetja kthehet në shtypje

Një nga elementët më tronditës në raste të tilla është përfshirja e familjarëve. Familja, që duhet të jetë hapësira më e sigurt për një individ, në disa raste kthehet në burim presioni dhe dhune. Jo gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por shpesh përmes heshtjes, justifikimit apo relativizimit të situatës.

Sa herë është dëgjuar fraza: “Duro pak, se kështu janë burrat”? Sa herë dhuna është minimizuar si “probleme familjare”? Këto nuk janë thjesht fjalë. Janë mekanizma që e mbajnë dhunën gjallë.

Institucionet dhe boshllëqet që kushtojnë jetë

Çdo rast i tillë ngre një pyetje të pashmangshme: a mund



të ishte parandaluar?

Në shumë raste, përgjigjja është po. Por kjo kërkon një zinxhir funksional institucionesh nga policia tek shërbimet sociale, nga sistemi gjyqësor tek mbështetja psikologjike. Kur një hallkë e këtij zinxhiri dështon, pasojat mund të jenë fatale.

Problemi nuk është vetëm mungesa e ligjeve. Në shumë vende, përfshirë Shqipërinë, legjislacioni ekziston. Problemi qëndron tek zbatimi, tek reagimi në kohë dhe tek ndjeshmëria ndaj sinjaleve paralajmëruese.

Sepse dhuna rrallëherë vjen papritur. Ajo paralajmëron. Por a jemi ne duke dëgjuar?

Një fenomen global, një përgjegjësi lokale

Dhuna ndaj grave nuk është vetëm një problem shqiptar. Është një fenomen global që prek shoqëri të ndryshme, pavarësisht nivelit të zhvillimit ekonomik apo kulturor. Por kjo nuk duhet të shërbejë si justifikim.

Çdo shoqëri ka përgjegjësinë të përballet me problemet e saj. Dhe në këtë rast, përgjegjësia është e shumëfishtë: e institucioneve që duhet të veprojnë e shoqërisë që duhet të reagojë, e individëve që nuk duhet të heshtin

Heshtja: Bashkëpunëtori i padukshëm i dhunës

Një nga faktorët më të fortë që e mban gjallë këtë fenomen është heshtja. Heshtja e viktimës, shpesh e diktuar nga frika apo mungesa e mbështetjes. Heshtja e fqinjëve, që “nuk duan të përzihen”. Heshtja e shoqërisë, që e trajton dhunën si diçka të largët. Por heshtja nuk është neutralitet. Është një formë bashkëpunimi pasiv. Në momentin që një shoqëri zgjedh të mos reagojë, ajo i jep hapësirë dhunës të vazhdojë.

Media: Mes informimit dhe sensacionit

Mënyra si raportohen këto ngjarje ka rëndësi të madhe. Titujt e shkurtër dhe sensacionalë mund të tërheqin

vëmendjen, por shpesh dështojnë të japin kontekstin dhe thellësinë e nevojshme.

Një jetë e humbur nuk është thjesht një “klik”. Është një histori që kërkon trajtim të kujdesshëm, analizë dhe përgjegjësi. Media ka fuqinë të ndikojë në mënyrën si shoqëria e percepton këtë fenomen dhe për rrjedhojë, edhe në mënyrën si reagon ndaj tij.

Parandalimi: Nga reagimi tek veprimi

Çdo editorial për këtë temë rrezikon të mbetet një reflektim i dhimbshëm nëse nuk shoqërohet me thirrje për veprim. Parandalimi kërkon më shumë se reagim pas ngjarjes. Kërkon: edukim që në moshë të hershme mbi respektin dhe barazinë, mekanizma të fortë raportimi dhe mbrojtjeje, mbështetje reale për viktimat, dhe një kulturë që nuk toleron dhunën në asnjë formë

Një apel që nuk duhet të mbetet vetëm fjalë

Historia e kësaj 25-vjeçareje nuk duhet të mbetet thjesht një lajm i radhës. Ajo duhet të jetë një pikë reflektimi. Një moment ku shoqëria ndalon dhe pyet veten: çfarë po bëjmë gabim?

Sepse çdo jetë e humbur në këtë mënyrë nuk është vetëm tragjedi individuale. Është një dështim kolektiv.

Sa jetë duhet të humbasin që të ndryshojmë?

Pyetja më e vështirë mbetet, sa raste të tilla duhen që të ketë një ndryshim real?

Sepse problemi nuk është se nuk dimë. Problemi është se shpesh nuk veprojmë.

Dhe deri në momentin që veprimi të zëvendësojë indiferencën, tituj si ai i sotmi do të vazhdojnë të përsëriten. Me emra të ndryshëm. Me histori të ndryshme. Por me të njëjtin fund tragjik. Një fund që nuk duhet të ishte kurrë pjesë e realitetit tonë.



Më 19 mars 1999, në një kohë sfidash të mëdha për sigurinë dhe stabilitetin në rajon, në radhët e Forcave të Armatosura shqiptare mori jetë një strukturë elitare, e ndërtuar mbi guximin, profesionalizmin dhe përkushtimin absolut ndaj detyrës: njësia e Asgjësimit të Municioneve të Pashpërthyer EOD (Explosive Ordnance Disposal). Ishte një grup i përzgjedhur me kujdes, ku u thirrën më të mirët e më të mirëve, burra dhe gra që pranuan të punojnë çdo ditë në kufirin e padukshëm mes jetës dhe vdekjes. Ky profesion nuk është thjesht një detyrë ushtarake. Është një mision që kërkon gjakftohtësi, vendimmarrje të menjëhershme dhe një qartësi mendore të jashtëzakonshme. Në çdo ndërhyrje, specialistët EOD përballen me rrezikun më ekstrem – një gabim i vetëm mund të jetë fatal. Dhe megjithatë, për 26 vite me radhë, ata kanë qenë aty ku rreziku është më i madh, për të garantuar sigurinë e të tjerëve.

Një histori suksesi dhe sakrifice

Që nga dita e parë e krijimit, kompania EOD ka ndërtuar një bilanc pune mbresëlënës, që flet më shumë se çdo fjalë. Mbi 1 mijë hektarë tokë janë pastruar nga municionet e paplasura, duke i kthyer këto zona nga territore rreziku në hapësira të sigurta për jetën dhe zhvillimin. Mbi 55 mijë tonë municione të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm janë asgjësuar me profesionalizëm të lartë, duke shmangur pasoja të rënda për komunitetet dhe infrastrukturën.

Në të njëjtën kohë, janë certifikuar 15 grup-depo, duke garantuar standarde të larta sigurie në menaxhimin e municioneve. Këto shifra nuk janë thjesht statistika ato janë dëshmi konkrete e një pune të palodhur dhe një përkushtimi të rrallë.

Por ky sukses nuk ka ardhur pa kosto. Në rrugën e tyre, specialistët EOD kanë derdhur edhe gjak. Pesë martirë ranë në krye të detyrës, duke e shndërruar sakrificën e tyre në një themel të shenjtë mbi të cilin qëndron sot kjo njësi elitare. Emrat e tyre janë gdhendur në historinë e ndritur të Forcave të Armatosura dhe do të kujtohen përjetë si simbol i trimërisë dhe devotshmërisë.

Nga Shqipëria në misionet ndërkombëtare

Profesionalizmi i specialistëve EOD nuk ka mbetur brenda kufijve të vendit. Përkundrazi, ai është vlerësuar dhe respektuar edhe në arenën ndërkombëtare. Shqipëria, ndonëse një vend i vogël në përmasa, ka arritur të ndërtojë një reputacion të fortë në këtë fushë specifike.

Pjesëmarrja në misione ndërkombëtare si ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë, EUTM Mali dhe angazhimi në grup-batalionin e NATO-s në Letoni, janë dëshmi e këtij suksesi. Prej vitesh, njësia EOD kontribuon në Letoni me rotacion çdo gjashtë muaj, duke ofruar një kapacitet të specializuar që vlerësohet lart nga aleatët.

Ky angazhim nuk është vetëm një kontribut për sigurinë ndërkombëtare, por edhe një tregues i nivelit të lartë profesional që kanë arritur Forcat e Armatosura shqiptare. Falë këtij përkushtimi, flamuri shqiptar është ngritur me dinjitet në misione të rëndësishme, duke forcuar imazhin e vendit në strukturat e NATO-s.

Një mision që shpëton jetë çdo ditë

Roli i specialistëve EOD në Shqipëri ka qenë jetik për dekada. Ata kanë operuar në disa nga zonat më të rrezikshme të vendit, ku prania e minave dhe municioneve të paplasura

26 vite në vijën e hollë mes jetës dhe vdekjes: Misioni fisnik i specialistëve EOD në Forcat e Armatosura

përbënte një kërcënim serioz për jetën e qytetarëve.

Në veri dhe verilindje, veçanërisht në zonat kufitare me Kosovën si Tropoja, Kukësi dhe Hasi, ekipet EOD kanë pastruar territore të tëra të ndotura nga konfliktet e së kaluarës. Në ish-zonat ushtarake dhe depot e municioneve, përfshirë edhe zona si Gërdec dhe Dumreja, ndërhyrjet e tyre kanë eliminuar rrezeqe të shumta.

Edhe në bregdetin jugor, në zona si Karaburun dhe Sazani, ku mbetjet eksplozive përbënin rrezik për zhvillimin turistik, puna e tyre ka qenë vendimtare. Falë këtyre ndërhyrjeve, shumë territore janë kthyer në hapësira të sigurta për banim, bujqësi dhe investime.

Profesionalizëm, teknologji dhe bashkëpunim

Suksesi i njësisë EOD mbështetet në një kombinim të fortë të profesionalizmit njerëzor dhe teknologjisë moderne. Specialistët përdorin pajisje të avancuara si detektorë metalikë, robotë dhe dronë me sensorë të specializuar për të identifikuar dhe neutralizuar rrezeqet.

Por përtej teknologjisë, ajo që bën diferencën është trajnimi i vazhdueshëm dhe përkushtimi i efektivëve. Ata jo vetëm që ndërhyjnë në terren, por edhe edukojnë komunitetet lokale për rrezeqet e municioneve të paplasura, duke rritur ndërgjegjësimin dhe parandaluar aksidentet.

Bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare ka qenë gjithashtu një faktor kyç në suksesin e këtij misioni, duke siguruar mbështetje teknike dhe financiare për operacionet e pastrimit.

Një njësi që përfaqëson krenarinë kombëtare

Sot, pas më shumë se një çerek shekulli, njësia EOD është një nga strukturat më të rëndësishme dhe më të respektuara të Forcave të Armatosura shqiptare. Ajo përfaqëson një

model të qartë të asaj që mund të arrihet kur profesionalizmi, përkushtimi dhe ndjenja e detyrës bashkohen në një mision të përbashkët.

Modernizimi i vazhdueshëm i pajisjeve dhe investimi në kapacitetet njerëzore e kanë transformuar këtë njësi në një aset strategjik për vendin dhe një partner të besueshëm për aleatët ndërkombëtarë.

Homazh për ata që dhanë gjithçka

Në këtë përvjetor, përulemi me respekt të thellë përpara sakrificës sublime të dëshmorëve që ranë në krye të detyrës: **major Klodian Tanushi, kapter Agim Mekollari, rreshter Namik Gjolenja, tetar Sadik Basha dhe nëntetar Zarife Hasanaj.**

Ata nuk janë vetëm emra në histori. Ata janë simbol i një përkushtimi të pakushtëzuar ndaj atdheut dhe jetës së të tjerëve. Sakrifika e tyre është një kujtesë e përhershme e çmimit që paguhet për sigurinë dhe paqen.

Një mision që vazhdon

Misioni i specialistëve EOD nuk përfundon kurrë. Për aq kohë sa ekziston rreziku i municioneve të paplasura, ata do të jenë në vijën e parë, duke mbrojtur jetën dhe të ardhmen e qytetarëve.

Në një botë ku sfidat e sigurisë janë gjithnjë në ndryshim, prania e tyre është më e nevojshme se kurrë. Dhe ndërsa Shqipëria vazhdon rrugën e saj drejt zhvillimit dhe integritit, njësia EOD mbetet një nga garancitë më të forta të sigurisë dhe stabilitetit. Krenarë për djemtë dhe vajzat tona, që çdo ditë zgjedhin të përballen me rrezikun për të mbrojtur jetën. Krenarë për një njësi që ka kthyer guximin në profesion dhe sakrificën në mision.



GJUHA: ARKIVI I SHPIRTIT DHE POEZIA E NJË KOMBI



ZENO JAHAJ

Gjuha është vepra më e madhe e përbashkët e një kombi. Më shumë se mjet ndërkuptimi: është bartëse e mendimit, kujtesës, kulturës, identitetit dhe vijimësisë së tij. “Gjuha është arkivi i historisë” – shkruante Ralph Waldo Emerson, madje “poezi e fosilizuar” teksa çdo fjalë ka qenë dikur një poezi, përderisa edhe fjalët më të zakonshme krijojnë metaforat më të fuqishme.

“Për atë diell që vete lodhur”! Nga nëna e kam dëgjuar këtë betim, e të gjitha nënat që kam njohur. Dielli si dëshmitar hyjnor, i pathyeshëm, i përjetshëm, po aq edhe njerëzor, që lindet, ndriçon, ngroh, jep jetë, sheh gjithçka dhe, në fund të ditës, lodhet dhe perëndon (bie për të pushuar). Betimi është solemn: ke hyrë në besë e në mirënjohje me lodhjen e Diellit, me një krijim të natyrës, domethënë me një poezi, teksa ka një ritëm të brendshëm, një trishtim të lehtë kozmik. Sjell ndërmend se vetë fjala “poezi”, në rrënjën e saj, do të thotë “krijim.”

Johann Gottfried Herder shkruante se “Gjuha e një populli është pasqyra e shpirtit të tij”. Martin Heidegger shkruante se “Gjuha është shtëpia e qenies.” Në fund të fundit, një komb jeton në gjuhën e tij.

Në shtëpinë e gjuhës: Kujtesa, drita dhe identiteti

Gjuhët me alfabet kanë respektivisht: shqipja 36 shkronja, anglishtja 26, frëngjishtja 26, italishtja 21, gjermanishtja 26 (+ ä, ö, ü, ß), spanjishtja 27, rusishtja 33, greqishtja 24, arabishtja 28 dhe hebraishtja 22 shkronja.

Numri i shkronjave të alfabetit nuk tregon që një gjuhë është “më e pasur” apo më e varfër”, “më e zhvilluar” apo “më pak e zhvilluar”. Thjesht flet për mënyrën se si një gjuhë vendos të përfaqësojë tingujt e saj në shkrim. Shqipja, duke ndjekur parimin “një tingull - një shkronjë”, ka më shumë shkronja, sepse edhe sh, dh, th, xh, gj, nj, rr, ll janë shkronja më vete. Pra, shqipja lexohet siç shkruhet, ndryshe, ta zëmë nga italishtja, në të cilën ch lexohet k, gn lexohet nj, e të tjera. Vërtet italishtja ka më pak shkronja, por përdor më shumë kombinime. Pra, numri i shkronjave nuk tregon pasurinë e fjalorit, as nivelin e qytetërimit, as kompleksitetin e mendimit.

Pra, arsyeja pse shumë gjuhëtarë e konsiderojnë shqipen si një nga gjuhët më fonetike të Europës është sepse ekziston një përputhje relativisht e fortë midis tingullit dhe shkrimit. Anglishtja, për shembull, është më pak fonetike ngase shumë grup-zanoresh të njëjta, lexohen ndryshe. P.sh. through lexohet thru, though lexohet dho, tough lexohet taf. Pra, shqipja është një gjuhë ku fjala shkruhet pothuajse siç dëgjohet dhe dëgjohet siç shkruhet. Në këtë kuptim, alfabeti shqiptar është pothuajse një hartë e zërit njerëzor shqiptar.

Pse shqipja është një nga gjuhët më fonetike në Europë

Është shkencërisht e pranuar se shqipja, degë më vete e familjes Indoevropiane, është gjuhë shumë e vjetër, ndoshta më e vjetra në Evropë.

Unë bashkohem me antropologjinë, gjenetikën dhe historinë serioze se shumica e popujve janë produkte të emigrimeve shumë të hershme dhe, në vijim, ndoshta edhe të mbishtresave e të formimeve kulturore. Një popull nuk përcaktohet vetëm nga gjaku apo origjina biologjike, por edhe nga kombinimi i gjuhës, kujtesës historike,



Një popull nuk banon vetëm në tokën e tij, por edhe në gjuhën e tij. Prej këtej, Shqipja është rrënja e padukshme që mban gjallë trungun e kombit shqiptar. Shqipja është shtëpia e kujtesës dhe horizonti i mendimit të kombit shqiptar.

territorit, vuajtjeve të përbashkëta, kulturës, institucioneve dhe vetëdijes së përbashkët. Prandaj edhe historianët konkludojnë se popujt nuk lindin. Ata formohen. Një identitet kolektiv kristalizohet kur një grup njerëzish qëndron për një kohë të gjatë në një territor, zhvillon gjuhë dhe mite të përbashkëta, krijon kujtesë historike.

Por bashkohem edhe me Bernd J. Fischer dhe Oliver Jens Schmitt, historianë modernë gjermanë, të specializuar në universitete të disa vendeve perëndimore për albanologji, e kështu mjaftueshmërisht të çliruar nga të menduarit mitik, të cilët shkruajnë: “Shqiptarët janë një prej grupeve më të mocme etnike autoktone në Ballkan, dhe në Evropë në përgjithësi.”

Studiuesi Robert Elsie, i doktoruar në gjashtë universitete kanadeze, gjermane, angleze dhe franceze, i specializuar në letërsinë dhe folklorin shqiptar, i cili i kushtoi kulturës, gjuhës, letërsisë dhe historisë së shqiptarëve gjithë jetën e tij, nuk le mëdyshje: “Ajo çka mund të themi me një siguri të arsyeshme, është se nuk ka provë që tregon se shqiptarët imigruan në Ballkanin jugperëndimor nga diku tjetër. Si të tillë, mund të pranohet me siguri si e vërtetë se ata janë originalisht vendas në rajon”.

Një emër i madh në fushën e antropologjisë dhe arkeologjisë, Aris A. Poulianos, i arsimuar në Athinë dhe doktoruar në dy universitete, New York e Moskë, autor i dhjetëra veprave shkencore kushtuar civilizimit të lashtë grek, shkruan: “Në Ballkan, njeriu ka ekzistuar së paku prej 500 000 vjetësh, ndoshta edhe më shumë... Një gjë mund të thuhet që në fillim se, bazuar në të dhënat antropologjike të

vendeve fqinjë, masa e madhe e popullsisë shqiptare është me origjinë autoktone që nga kohët e hershme parahistorike”.

Këtij përfundimi i bashkohet edhe akademiku britanik, Malcolm: “në rastin e shqiptarëve ...ata janë populli i vetëm në Ballkan që ka prejardhje të qartë nga civilizimi para-romak, nga shoqëritë para-romake”.

Pa gjuhën, gjakun, tokat, vuajtjet dhe arritjet e përbashkëta, zor se shqiptarët do të kishin mbijetuar midis qytetërimeve nga më të hershmit dhe nga më të fuqishmit e njerëzimit.

Alfabeti dhe tingulli: Veçantia e gjuhës shqipe

Në kushtet e izolimit relativ historik për shekuj të tërë, të jetës në zona malore, pa administratë të përbashkët shkrimore dhe me traditë të ruajtur vetëm me gojë, ndodh diçka interesante në gjuhë: autoriteti kryesor bëhet tingulli, jo shkrimi. Shqipja u shkrua vonë, por është dëgjuar shumë gjatë. Kur një gjuhë ruan me kujdes tingujt e saj, ajo ruan edhe mënyrën e të folurit, kujtesën kolektive, vazhdimësinë kulturore. Kështu, alfabeti i shqipes nuk është thjesht akt vetëm teknik, por kryesisht akt identitar.

Wilhelm von Humboldt, një themelues i gjuhësisë moderne, shprehej se çdo gjuhë përfaqëson një botëkuptim unik. Kjo do të thotë se popujt nuk ndryshojnë vetëm nga historia, por nga mënyra si gjuha e tyre organizon mendimin. Ideja kyçe e tij është se njeriu krijon botën përmes gjuhës. Njerëzimi është një, por botën e sheh në mënyra të ndryshme përmes gjuhëve të ndryshme.



Identiteti është proces historik, jo trashëgimi e ngrirë. Një popull mund të ndryshojë përbërjen biologjike shumë herë, por mbetet i njëjtë për sa kohë vazhdon gjuha dhe tradita mendore.

Krijon gjuha popullin, apo populli krijon gjuhën? Përgjigja më e arsyetuar është se të dyja krijojnë njëra-tjetrën në mënyrë të vazhdueshme, në një proces rrethor dhe të gjallë, jo si marrëdhënie njëkahëshe. Në fillim populli krijon gjuhën, pastaj gjuha fillon të krijojë popullin, sepse, pasi gjuha stabilizohet, ajo formon mënyrën e të menduarit, përcakton kategoritë mendore, krijon kujtesë kolektive. Pra: populli dhe gjuha janë bashkëkrijues. Formula e plotë e Humboldt është se njerëzit krijojnë gjuhën, gjuha formëson mendimin, mendimi i përbashkët krijon popullin, populli ndryshon përsëri gjuhën.

Një popull nuk flet vetëm gjuhën. Ai mendon nëpërmjet saj. Prej kësaj ideja e filozofit Ludwig Wittgenstein: “Kufijtë e gjuhës sime janë kufijtë e botës sime”. Pra, gjuha nuk është vetëm mjet shprehjeje. Ajo është horizonti brenda të cilit një komb e kupton botën.

Disa studiues kanë vënë re se tiparet strukturore të shqipes lidhen me mënyrën karakteristike të të shprehurit dhe të menduarit shqiptar. Ky nuk është një ligj absolut, por një vëzhgim kulturor-gjuhësor. Shqipja, duke qenë gjuhë shumë fonetike dhe konkrete, në të cilën fjala shqiptohet siç shkruhet, forma gramatikore është shpesh e drejtpërdrejtë, fjalitë tradicionale janë të shkurtra dhe të forta. Prej kësaj edhe stili i komunikimit në shqip: i drejtpërdrejtë, i prerë, me ngarkesë kuptimore të përqendruar. Tradita e gjatë gojore dhe mendimi figurativ kanë krijuar metafora shumë të forta me figuracion konkret (gur, rrënjë, dritë, diell, gjak, tokë, etj.).

Një popull nuk banon vetëm në tokën e tij, por edhe në gjuhën e tij. Prej kësaj, Shqipja është rrënja e padukshme që mban gjallë trungun e kombit shqiptar. Shqipja është shtëpia e kujtesës dhe horizonti i mendimit të kombit shqiptar.

Struktura e shqipes dhe miti i ‘pasurisë’ së gjuhëve

Në gjuhën shqipe, një fjalë shpreh shumë kuptime, për të cilat, le të themi, anglishtja, ka fjalë të ndryshme. A do të thotë kjo se shqipja është e varfër apo e pasur, që nuk begenis të merret me hollësira, përtace, aristokrate?

Për shembull, për fjalën “i/e mirë”, shqipja përcakton ushqim i mirë (cilësi), mot i mirë (gjendje), ide e mirë (vlerësim intelektual), punë e mirë (rezultat), jam mirë (gjendje personale), burrë / grua i/e mirë (vlerësim karakteri).

Anglishtja, përcaktimin “i/e mirë”, e specifikon për fusha të ndryshme: ushqim i mirë (tasty), mot i mirë (nice weather), ide e mirë (smart, clever, good idea), jam mirë (well, fine), cilësi e mirë (high-quality), burrë / grua i/e mirë (kind).

Por kjo nuk do të thotë se anglishtja është më e pasur. Sepse gjuhësia moderne ka një parim pothuaj universal: të gjitha gjuhët natyrore janë po aq të afta për të shprehur çdo ide njerëzore. Pra, pasuria nuk matet me numrin e fjalëve, numrin e sinonimeve, apo ndarjet leksikore. Ndryshimi nuk është varfëri apo pasuri. Thjesht kemi gjuhë analitike (si anglishtja) dhe gjuhë sintetike (si shqipja). Gjuhët analitike i ndajnë konceptet, ndërsa gjuhët sintetike i bashkojnë konceptet.

Në grupin e saj, shqipja i bashkon më shpesh konceptet. Por kjo nuk do të thotë se shqipja është “përtace”. Në të kundërt, kur një fjalë ka shumë kuptime, folësi duhet të lexojë kontekstin, tonin, marrëdhënien sociale, situatën. Kjo kërkon më shumë interpretim, jo më pak, pra është ekonomi shprehjeje, jo dembelizëm. Madje, mund të argumentohet e kundërta: fjala “i/e mirë” krijon hapësirë interpretimi, jo kufizim. Pra, në rastin e shqipes kemi një koncept, një bërthamë kuptimi. Shumë gjuhë të lashta kishin një fjalë të vetme që bashkonte të mirën morale, të bukurën, të dobishmen, të përshtatshmen. Kështu shqipja ruan diçka shumë të hershme, të lashtë dhe filozofike: idenë që e mira, e bukura dhe e dobishmja nuk janë plotësisht të ndara.

Në shumë gjuhë moderne, e moralshmja (“good” në anglisht), u nda nga e bukura (“beautiful”), ndërsa në gjuhë më të vjetra ato ishin pothuaj një koncept i vetëm. “Njeri i mirë” në shqip mund të nënkuptojë i drejtë, i butë, bujar, i ndershëm, i pafajshëm.

Kemi, pra, dy stile të civilizimit gjuhësor: stil analitik (anglisht, frëngjisht) në të cilin ka ndarje të imët kategorish dhe stil sintetik / konceptual (më tipike te shqipja), një bërthamë e cila shpreh kuptime të gjera. Kjo nuk lidhet me inteligjencë apo kulturë, por me histori zhvillimi: disa gjuhë e analizojnë botën, të tjera e sintetizojnë atë. Një gjuhë që sintetizon nuk është më pak e saktë. Thjesht ajo sheh lidhjet përpara ndarjeve. Në rastin e shqipes mund të krijohet ndjesia “aristokratike”, sepse me spektrin e gjerë që ajo përdor krijon më pak klasifikim, por më shumë gjykim të përgjithshëm, një lloj distance nga detaji teknik. Ngjan me stilin klasik filozofik ose poetik: thua pak, nënkupton shumë. Prandaj shqipja shpesh tingëllon më proverbiale, më e përmbledhur por me më shumë peshë, më e shkurtër por më e thellë në mendim. Shkurt: shqipja është “aristokrate”, sepse preferon konceptin e fjalës në vend të listimit të kuptimeve.

Pse, për shembull, fjala shqiptare “besë” është pothuajse e papërkthyeshme plotësisht në gjuhë të tjera? Kjo nuk do të thotë që gjuhët e tjera nuk kanë koncepte të ngjashme, por që asnjë fjalë e vetme nuk mbulon të gjithë fushën kuptimore dhe përmasat që kjo fjalë ka në shqip. Në kuptimin shqip, fjala “besë” përfshin njëkohësisht premtim, besim, nder moral, garanci personale, përgjegjësi ndaj tjetrit, siguri sociale. Pra fjalë e dhënë bëhet ligj moral, në atë shkallë sa, tradicionalisht, ndër shqiptarë, nëse është dhënë “besa” me fjalë, nuk ka patur nevojë për dokument të shkruar për ta lidhur detyrimin juridikisht. Pra, nuk është vetëm një ndjenjë. Është institucion moral, sepse vendos nderin dhe identitetin si garanci.

Sipas frymës së Wilhelm von Humboldt: kur një koncept është jetik për organizimin e jetës shoqërore, gjuha krijon një fjalë bërthamë për të. Në shoqëritë ku ligji shtetëror ishte i dobët ose i largët, marrëdhëniet mbështeteshin te reputacioni personal dhe, për këtë, duhej një mekanizëm besimi, “besa”, e cila në kushtet e mungesës së shtetit, funksiononte si kontratë morale.

Përse në shqip, etimologjia e fjalës “faleminderit” është krejt e ndryshme nga pothuajse të gjitha gjuhët, edhe pse kuptimi është i njëjtë?

Koncepti “faleminderit” përbëhet nga fjala “falem” dhe “nderit”, që shkon për “I falem nderit që më bëre.” Pra, falënderimi në shqip është akt moral, jo thjesht reagim emocional. Pothuajse të gjitha gjuhët e tjera, për të shprehur falënderimin nuk përdorin strukturë gjuhësore morale, por modele thuajse teknike, pak a shumë si punë borxhi: në Frëngjisht “merci” (nga Latinishtja merces që do të thotë shpërblim, pagesë); në Italisht “grazie” e Spanjisht gracias (nga fjala Latine gratia që do të thotë hir, favor); në Gjermanisht “danke” që lidhet me fjalën “denken” (që do të thotë të mendosh, pra një vlerësim mendor).

Përndryshe, shqipja nuk thotë “po mendoj mirë për ty”, apo “kam marrë hir, favor nga ty”, apo “po të paguaj simbolikisht”. Ajo thotë: “I falem nderit që më bëre” që është krejtësisht hyjnore (falja, lutja). Pra, shumë gjuhë europiane duket se pasqyrojnë marrëdhëniet tregtare të lindura e zhvilluara në qytete të mëdha, në administrata e sisteme juridike ku falënderimi u konceptua si mirënjohje, favor, shkëmbim simbolik. Ndërsa struktura shqiptare pasqyron një botë ku nderi personal ishte kapitali kryesor social dhe prestigji zëvendësonte kontratën.

Shqipja: Midis tingullit, mendimit dhe historisë

Është kjo arsyeja pse gjuhët me fjalë shumë të përgjithshme shpesh prodhojnë më shumë poezi dhe proverba, ndërsa gjuhët me shumë ndarje prodhojnë më lehtë ligjërim shkencor. Shqipja hyn në gjuhët sintetike-konceptuale që, me pak fjalë, shpreh shumë kuptime. Anglishtja dhe disa të tjera priren për nga gjuha analitike-specializuese që përdorin fjalë specifike për kuptime të ngushta.

Shqipja favorizon poezinë, sepse kanë të përbashkët shumëkuptimësinë, dykuptimësinë e kontrolluar dhe rezonancën emocionale. Për shembull, një fjalë me diapazon të gjerë si “mirë” nuk e mbyll kuptimin, lë hapësirë imagjinateve dhe aktivizon përvojën personale të lexuesit. Për shembull, te “Fjala e mirë hap derën”, “e mira” nuk specifikohet nëse është morale, e butë, e mençur apo e drejtë. Pikërisht ky diapazon i gjerë e bën më shprehëse deri edhe poetike. Është kjo arsyeja që edhe proverbat lindin lehtë në këtë strukturë, sepse proverbii kërkon përgjithësim universal, ekonomi fjalësh, elasticitet interpretimi. Fjalët me kuptim të gjerë funksionojnë si simbole, jo si etiketa teknike.

Shkenca kërkon të kundërtën: një term është baras një kuptim, është eliminim i dykuptimësisë, ndarje precize konceptuale. Shkenca kërkon qartësi absolute, jo rezonancë. Kjo ndodh sepse historikisht, shoqëritë që zhvillojnë administratë të madhe, teknologji, shtet (burokraci), universitete, etj., iu duhet të krijojnë terminologji të specializuar. Është kjo arsyeja që anglishtja moderne u mbush me fjalë latine dhe greke.

Prej kësaj, ndërsa gjuhët me traditë të fortë orale (me gojë) ruajnë konceptet bërthamë, shprehjen figurative dhe densitetin poetik. Kjo nuk do të thotë se gjuhët poetike janë më pak të sakta. Thjesht ato janë më të sakta konceptualisht në bërthamë, por më pak të sakta për klasifikimin teknik. Përkundër, gjuhët shkencore janë shumë të sakta për objektet, por më pak elastike për ndjenjat.

NUREDIN GORÇE



Ylli i pashuar i detyrës dhe nderit ushtarak

Në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare ka emra që nuk zbehen me kalimin e viteve, por përkundrazi ndriçojnë më fort në ndërgjegjen kombëtare. Një ndër ta është edhe Nuredin Gorçe, Kapiten i Parë dhe një nga figurat më përfaqësuese të sakrificës në krye të detyrës.

Motoja e përjetshme “Kush bie për atdhe, mbetet një yll i pashuar” mishërohet plotësisht në jetën dhe rënien heroike të tij. Në përvjetorin e rënies, kujtesa jonë kolektive rikthehet tek ato ditë të vështira të marsit 1997, kur shteti shqiptar u përball me një nga krizat më të thella të historisë së tij moderne.

Në atë kohë trazirash dhe pasigurie, kur rendi dhe institucionet u vunë në provë ekstreme, Brigada “Komando” e Zall-Herrit u shndërrua në një bastion të qëndrësës dhe profesionalizmit. Mes kaosit dhe presionit të turmave të irrituara, ushtarakët e kësaj njësie elitë zgjodhën detyrën, nderin dhe përgjegjësinë ndaj vendit.

Në krye të kësaj qëndrese ishte edhe Kapiten Nuredin Gorçe, shef i Xhenios, një oficer i përkushtuar që nuk u tërhoq përballë rrezikut. Aira në krye të detyrës, duke mbrojtur infrastrukturën ushtarake dhe duke kontribuar në ruajtjen e një prej strukturave më të rëndësishme të ushtrisë

shqiptare në ato momente kritike.

Rënia e tij nuk ishte vetëm një humbje për shokët dhe familjen, por një sakrificë që i dha kuptim më të thellë misionit të Forcave të Armatosura. Ajo u bë simbol i qëndrësës, i disiplinës dhe i besnikërisë ndaj flamurit dhe atdheut.

Falë vendosmërisë së tij dhe të kolegëve të tij, Brigada “Komando” jo vetëm që mbijetoi, por u kthye në një shembull frymëzimi për gjithë strukturat ushtarake të vendit. Më vonë, kjo njësi do të vazhdonte të mbante lart emrin e Shqipërisë në misione ndërkombëtare në Bosnje-Hercegovinë, Afganistan, Irak, Çad dhe Kosovë. Sot, pas shumë vitesh, figura e Kapiten Nuredin Gorçes mbetet e gjallë në memorien e bashkëluftëtarëve dhe në historinë e ushtrisë shqiptare. Ai nuk është thjesht një dëshmor, por një model i ushtarakut ideal i përkushtuar, i guximshëm dhe i palëkundur në detyrë.

Çdo 20 mars, kur përkulemi me respekt përpara kujtimit të tij, ne nuk kujtojmë vetëm një njeri, por një vlerë të përjetshme: sakrificën për atdheun.

Heronjtë si Nuredin Gorçe nuk largohen kurrë, ata mbeten përjetësisht yje të pashuar në qiellin e kombit.

“

Motoja e përjetshme “Kush bie për atdhe, mbetet një yll i pashuar” mishërohet plotësisht në jetën dhe rënien heroike të tij. Në përvjetorin e rënies, kujtesa jonë kolektive rikthehet tek ato ditë të vështira të marsit 1997, kur shteti shqiptar u përball me një nga krizat më të thella të historisë së tij moderne.



NGA MAJOR (R) NEXHBEDIN BASHA

Në korrik të vitit 2008, ndërsa qendra e Gërdecit ende dridhej nga pasojat e tragjedisë së 8 marsit, mora lajmin që do të ndryshonte jetën time: do të isha komandant i kontingjentit të parë shqiptar në Çad. Një mision historik, pjesë e operacionit EUFOR TCHAD/RCA, nën komandim operacional të Bashkimit Europian dhe me marrëveshje dypalëshe me Ministrinë e Mbrojtjes së Francës.

Pesha e përgjegjësisë nuk mund të matet vetëm me gradë, as me flamur; është ajo që të rrëmben mendjen dhe të shtrëngon zemrën.

Natën pas lajmit nuk gjeta gjumë. Shumë pyetje më mundonin: A jemi gati? Si do t'i drejtoja 62 ushtarakët? Si do t'i përballonim situatat?

Kisha përvojë nga Bosnja dhe Iraku, por asgjë nuk të përgatit për momentin kur je vetë përgjegjës për jetët e të tjerëve. Komandanti im, nënkolonel Xhelal Laçi, më dha lajmin personalisht, dhe unë e kuptova menjëherë se karriera ime nuk do të ishte më e njëjtë pas asaj dite.

Përgatitja: Prova para misionit

Përgatitja ishte intensive. Tre muaj në Zall-Herr, stërvitje nën diellin e zjarrtë:

- pika vrojtimi
- patrullime
- shoqërim konvojesh
- menaxhim turmash
- detyra të paqeruajtjes

Një informacion i çmuar nga grupi i rikonicionit i Shtabit të Përgjithshëm, i kryesuar nga kolonel Hysen Cekodhima, paralajmëroi për rrezikun më të madh natyror: **ethet e verdha të Çadit**.

Brigada dhe Shtabi i Përgjithshëm bënë gjithçka për të vaksinuar kontingjentin. Asgjë nuk lihej rastësisht.

Nisja: Momenti i amanetit

Mëngjesi i nisjes në Rinas ishte i mbushur me zhurmën e avionit francez, dridhjet e zërave të nënave dhe përqafimet e fundit të familjeve...

Gjenerallejtënant Luan Hoxha, ministri Gazmend Oketa, kolonel Xhemal Gjunkshi, ambasadori dhe atasheu francez, ishin të gjithë aty, solemnisht.

Kur ministri ma dorëzoi flamurin, ndjeva çdo fibrë të tij. Ai nuk ishte thjesht pëlthurë ishte **amanet**. Në një anë pashtë nënën dhe dy djemtë e mi; në anën tjetër babain dhe fjalët e



FLAMURI NË DUAR, AMANETI NË ZEMËR

Rrëfimi i Nënkolonel Bekim Fisnikut, Komandant i parë i kontingjentit shqiptar në misionin EUFOR TCHAD/RCA, Çad



dajës tim Nexhbedini: “Nipçe, vlerëso këtë mundësi dhe na ndero. Dalsh faqebardhë!”

Çadi: Përballja me realitetin

Udhëtimi drejt Ndjamena-s zgjati rreth gjashtë orë. Nxehtësia e 50 gradëve të Saharasë na goditi menjëherë. Prej atij momenti: çdo ditë, çdo vendim, çdo hap ishte test.

Në kampin “Europa”, u vendosëm në katër çadra: tre për ushtarët, një për shtabin. Ato u bënë shtëpia jonë për nëntë muaj.

Koordinimi me kontingjentet suedeze ishte i vazhdueshëm. Ata na dorëzonin detyrën e sigurisë së bazës dhe bashkë me të, peshën e përgjegjësisë.

Një moment historik

Ceremonia e marrjes së detyrës ishte e paharrueshme. Në sheshin e rreshtimit, nën diellin afrikan, flamuri shqiptar u ngrit krahas atyre të vendeve të BE-së.

Në atë çast: nuk u ngrit vetëm një flamur — u shkrua histori.

Misioni

Detyra jonë ishte e qartë: Mbrojtja e popullsisë civile dhe refugjatëve; Sigurimi i ndihmave humanitare; Mbrojtja e staftit të OKB-së; Siguria e bazës “Europa”; Patrullime dhe kontroll territori dhe Shoqërim konvojesh.

Kontingjenti shqiptar përbëhej nga 63 efektivë të Kompanisë së parë të Batalionit I Komando, në bashkëpunim me: Francën, Austrinë, Belgjikën, Holandën, Gjermaninë, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar, Poloninë, Suedinë, Spanjën, Rumaninë, Portugalinë, Irlandën, Finlandën, Estoninë,

Greqinë, Slloveninë, Bullgarinë, si dhe Kroacinë dhe Rusinë.

Kujtimet që mbeten

Çfarë mbaj mend më shumë? Netët e gjata në Saharë. Era e thatë që depërtonte çdo mendim. Vendimet e vështira pa hezitim. Dhe mbi të gjitha... 62 “djem nënash” që i çova dhe i ktheva të gjithë shëndoshë e mirë. Ky ishte misioni më i madh: i shtetit, i flamurit, i nderit.

Jetëshkrimi dhe karriera

Bekim Sejfulla Fisniku ka lindur, më 26 mars 1977, në Dibër. Në vitin 1999 përfundoi Akademinë Ushtarake dhe mori gradën ‘nëntoger’. Rrugëtimi i tij është ndërtuar mbi: besnikëri, profesionalizëm dhe përkushtim.

Një moment kyç ishte edukimi në **US Army Command and General Staff College**, Fort Leavenworth, Kansas.

Misionet ndërkombëtare:

- Bosnje-Hercegovinë (2001)
- Irak (2005–2006)
- Çad (2008–2009)
- Afganistan (2016)

Ka shërbyer ndër vite si komandant toge, shef shtabi dhe atashe ushtarak në Gjermani. Më pas ka mbajtur detyrën e zëvendës përfaqësuesit ushtarak në NATO (ACO-SHAPE, Mons).

Bekim Fisniku aktualisht mban gradën Nënkolonel dhe ushtron detyrën si Oficer Shtabi për Stërvitjen e Forcës Tokësore në Drejtorinë e Operacioneve dhe Stërvitjes J-3/7 pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Formimi i tij profesional përfshin Kursin Komando, trajnime të avancuara për shtabin, si dhe seminare e kualifikime ndërkombëtare në kuadër të NATO-s.

Zotëron gjuhët angleze dhe gjermane, ndërsa kontributi i tij është vlerësuar me dekorata nga NATO, Bashkimi Europian dhe Ministria e Mbrojtjes.

Familja, forca pas uniformës



Pas çdo misioni qëndron familja: Bashkëshortja Marsela dhe fëmijët: Henri, Brisel dhe Hersa. Ata kanë ndjekur çdo hap të tij me krenari dhe durim.

Flamuri në Çad nuk ishte vetëm simbol i shtetit. Ai ishte: amanet i një familjeje, besim i një kombi, përgjegjësi e një ushtaraku.

Në këtë rrëfim ka më shumë se histori - ka nxehtësi, sakrificë, vendime dhe nder. **Sepse flamuri mbahet në duar... por amaneti jeton në zemër.**

LUFTA E MASHKULLORËS (1908)

Një epope e rezistencës shqiptare kundër Perandorisë Osmane

Më 18 mars 1908, forcat osmane ndërmorën një sulm të organizuar kundër çetës së udhëhequr nga Çerçiz Topulli në fshatin Mashkullorë, pranë Gjirokastrës. Edhe pse përballë një force shumë herë më të madhe në numër, kryengritësit shqiptarë arritën të përballonin sulmin dhe të çanin rrethimin, duke hyrë në histori me një nga aktet më të spikatura të qëndresës së armatosur.

Kjo betejë, e njohur si **Lufta e Mashkullorës**, përbën një moment të rëndësishëm në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila në këtë periudhë po shihte gjithnjë e më shumë luftën e armatosur si një mjet të domosdoshëm për arritjen e objektivave politike dhe kombëtare.

Nga atentati te përplasja e armatosur

Ngjarjet që çuan në këtë përballje kanë zanafillën më 25 shkurt 1908, kur çeta e Çerçiz Topullit realizoi një nga aksionet më të bujshme të kohës: vrasjen e bimbashit osman të Gjirokastrës, Halil Musa Beut, komandant i xhandarmërisë.

Ky veprim u ndërmor me vendim të Komitetit “Për Lirinë e Shqipërisë”, një organizatë patriotike që vepronte në mënyrë të fshehtë dhe kishte si synim organizimin e kryengritjes kundër pushtimit osman. Detyra për realizimin e atentatit iu besua çetës së Çerçizit dhe urdhri iu përcoll nga patrioti i njohur Idriz Guri.

Përpjekjet e para për eliminimin e bimbashit dështuan për shkak të masave të forta të sigurisë. Më në fund, më 25 shkurt, gjatë ditës së pazarit, atentati u realizua me sukses nga Hito Lekdushi dhe Barjam Pergjia, të cilët kishin hyrë në qytet të maskuar si tregtarë.

Pas atentatit, çeta u tërhoq drejt Mashkullorës, duke hyrë në një fazë të re përballjeje të drejtpërdrejtë me forcat osmane.

Rrethimi në Mashkullorë

Pas disa ditësh lëvizjeje dhe përpjekjesh për të shmangur ndjekjen, çeta u nda në dy pjesë për të manovruar më lehtë. Një grup i vogël, i udhëhequr nga vetë Çerçizi, mbeti në Mashkullorë.

Sipas kujtimeve të Mihal Gramenos, që ishte pjesë e çetës, qëndrimi në këtë zonë u diktua edhe nga rrethanat atmosferike dhe sigurimet e vendasve se nuk kishte rrezik të menjëhershëm.

Megjithatë, në agimin e 18 marsit, situata ndryshoi papritur. Çerçiz Topulli dha alarmin me thirrjen e tij tashmë legjendare: **“O burrani, shokë, se na rrethoi ushtria!”**

Zhvillimi i betejës

Çeta u detyrua të largohej me shpejtësi nga streha dhe të zinte pozicione mbrojtëse në një terren të përshtatshëm, pranë një ndërtese të braktisur.

Në momentet e para të përleshjes, u vra një nga luftëtarët më të rinj, Hajredin Tremishti, ndërsa një tjetër, Hito Lekdushi, u detyrua të largohej, duke e reduktuar më tej numrin e mbrojtësve.

Çeta mbeti me vetëm pesë luftëtarë përballë rreth 150 ushtarëve osmanë. Luftimet vazhduan për orë të tëra, nga mëngjesi deri në mbrëmje, nën një presion të vazhdueshëm dhe të pamëshirshëm.

Pavarësisht epërsisë numerike të armikut, kryengritësit shqiptarë arritën të shkaktonin humbje të konsiderueshme në radhët e forcave osmane, duke vrarë rreth 20 ushtarë, përfshirë edhe drejtues të tyre.

Heroizmi në betejë

Figura e Çerçiz Topullit gjatë betejës përshkruhet me admirim nga bashkëluftëtari i tij, Mihal Grameno:

“Zbathur, lakuriq, kokëjashtë, me leshrat përpjetë vërtiteshe në të gjitha anët si një komandant i madh... jo sikur luftonte, por sikur kërcente.”

Ky përshkrim pasqyron jo vetëm guximin, por edhe moralin e lartë luftarak që karakterizonte udhëheqësin e çetës.

Gjatë betejës u plagosën vetë Çerçiz Topulli dhe Myftar Axhemi, por qëndrueshmëria e tyre nuk u thye.



Çarja e rrethimit dhe tërheqja

Në mbrëmje, duke përfutur nga errësira dhe terreni, çeta arriti të çajë rrethimin dhe të tërhiqet në mënyrë të fshehtë.

Pas tërheqjes, luftëtarët gjetën strehim në një çiflig miqësor, ku sipas kujtimeve të kohës, ata u ushqyen pas një dite të gjatë dhe të lodhshme luftimesh – një episod që mbetet ndër më njerëzorët e kësaj ngjarjeje heroike.

Jehona dhe rëndësia historike

Lufta e Mashkullorës pati një jehonë të gjerë jo vetëm në Gjirokastrë, por edhe përtej kufijve të Perandorisë Osmane. Ajo u bë simbol i rezistencës shqiptare dhe i vendosmërisë për liri.

Ngjarja u përjetësua në këngët popullore polifonike si: “Hyri prilli doli marsi”; “Te Rrapi në Mashkullorë”, etj.

Këto këngë e ruajnë gjallë kujtesën historike dhe shpirtin e asaj përballjeje.

Figura kryesore të lëvizjes

Përveç Çerçiz Topulli, një rol të rëndësishëm në këtë periudhë luajtën edhe:



ÇERÇIZ TOPULLI

Bajo Topulli – organizator i shquar i çetave kryengritëse
Mihal Grameno – dëshmitar dhe kronikan i ngjarjeve

Këto figura kontribuan ndjeshëm në organizimin dhe përhapjen e lëvizjes kombëtare në Shqipërinë e Jugut.

Kujtesa dhe përjetësimi

Në nder të Çerçiz Topullit, më 18 mars 1934, në Gjirokastrë u përrua një shtatore monumentale, vepër e skulptorit Odhise Paskali. Kjo vepër u realizua falë kontributit të qytetarëve dhe emigrantëve shqiptarë.

Ceremonia e përrimit ishte madhështore dhe u shoqërua me këngë dhe valle tradicionale, duke reflektuar respektin dhe mirënjohjen e popullit për figurën e heroit.

Lufta e Mashkullorës mbetet një nga episodet më domethënëse të historisë ushtarake shqiptare. Ajo dëshmon se edhe një forcë e vogël, e motivuar nga ideali i lirisë, mund të përballlet me sukses ndaj një armiku shumë më të madh.

Kjo betejë nuk ishte vetëm një përballje e armatosur, por një akt i fuqishëm i ndërgjegjes kombëtare shqiptare një dëshmi e qartë e rrugës drejt pavarësisë.



MIHAL GRAMENO

BASHKËJETESA FETARE, themeli i një kombi që di të qëndrojë i bashkuar

Në një kohë kur bota shpesh përballet me ndarje të thella mbi baza fetare, etnike apo kulturore, Shqipëria vijon të mbetet një shembull i rrallë i harmonisë dhe bashkëjetesës. Kjo vlerë nuk është ndërtuar brenda natës dhe as nuk është një mit i krijuar për konsum publik, ajo është një realitet i provuar në kohë, i ushqyer nga historia, kultura dhe mbi të gjitha nga vetëdija e një populli që ka ditur të vendosë bashkimin mbi dallimin.

Pranvera e këtij viti sjell me vete një kalendar të pasur festash fetare. Besimtarët myslimanë kremtojnë Bajramin pas një muaji sakrifice dhe përkushtimi, besimtarët bektashinj festojnë Sulltan Nevruzin si simbol të ringjalljes shpirtërore dhe natyrore, ndërsa më tej vijnë Pashkët Katolike dhe ato Ortodokse, që mbartin mesazhin e ringjalljes dhe shpresës. Këto festa, megjithëse të ndryshme në ritual dhe traditë, takohen në një pikë të përbashkët, ato i japin njeriut forcë shpirtërore dhe e ftojnë atë drejt mirësisë, faljes dhe solidaritetit.

Në Shqipëri, këto festa nuk jetojnë të ndara. Ato nuk janë kufij që ndajnë komunitetet, por ura që i lidhin ato. Në shumë familje shqiptare, tryeza e Bajramit ndahet nga të gjithë, ashtu si edhe vezët e Pashkëve apo ëmbëlsirat e Nevruzit. Nuk është e rrallë që një familje të ketë anëtarë me besime të ndryshme, por që jetojnë në harmoni të plotë, duke respektuar dhe ndarë gëzimin e njëri-tjetrit. Kjo është një pasuri që nuk matet me statistika, por me përjetime të përditshme.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë një pasqyrë e qartë e kësaj shoqërie. Në radhët e tyre shërbejnë të rinj e të reja nga të gjitha trevat, me bindje dhe besime të ndryshme, por të bashkuar nën të njëjtën uniformë dhe flamur. Brenda një reparti ushtarak, dallimet fetare nuk zhduken, por harmonizohen. Ato bëhen pjesë e një identiteti më të madh, identitetit të ushtarakut shqiptar, i cili vendos detyrën dhe shërbimin ndaj atdheut mbi çdo gjë tjetër.

Në këtë periudhë të veçantë, shumë të rinj në Forcat e Armatosura zgjedhin të agjërojnë. Ata vazhdojnë stërvitjen, shërbimin dhe angazhimet e tyre ditore, duke përballuar njëkohësisht sfidat fizike dhe ato shpirtërore. Ky është një tregues i qartë i forcës së karakterit dhe disiplinës që i karakterizon. Agjërimi, në këtë kontekst, nuk është vetëm një praktikë fetare, por edhe një ushtrim i vullnetit dhe vetëkontrollit – vlera që përputhen natyrshëm me jetën ushtarake.

Institucionet ushtarake kanë treguar vazhdimisht ndjeshmëri dhe respekt ndaj këtyre praktikave. Krijimi i kushteve për ushtrimin e besimit, pa cenuar misionin dhe gatishmërinë operationale, është një tregues i pjekurisë institucionale. Kjo qasje jo vetëm që forcon moralin e efektivëve, por edhe ndërton një kulturë respekti dhe mirëkuptimi brenda strukturave të mbrojtjes.

Historia shqiptare është e mbushur me shembuj të bashkëjetesës fetare. Në momentet më të vështira për kombin, shqiptarët nuk janë ndarë sipas besimit, por janë bashkuar për të mbrojtur atë që i përkiste të gjithëve. Që nga periudhat e pushtimeve e deri te sfidat moderne, uniteti ka qenë gjithmonë arma më e fortë. Figura të shquara të historisë sonë kanë ardhur nga besime të ndryshme, por kanë kontribuar njësoj për të njëjtin ideal kombëtar.



Në këtë kontekst, bashkëjetesa fetare nuk është thjesht tolerancë. Toleranca nënkupton pranimin e tjetrit, ndërsa bashkëjetesa shqiptare shkon më tej, ajo nënkupton respekt aktiv, ndarje gëzimi dhe dhimbjeje, dhe një ndjenjë të përbashkët përkatësie. Është një model që nuk mbështetet vetëm në ligje apo rregulla, por në një kulturë të brendshme që transmetohet brez pas brezi.

Sot, në një realitet global ku ekstremizmi dhe keqinterpretimet fetare shpesh krijojnë tensione, Shqipëria ofron një shembull pozitiv. Ky model nuk duhet parë si diçka e vetëkuptueshme apo e përhershme pa përpjekje. Ai duhet ruajtur, kultivuar dhe forcuar çdo ditë, përmes edukimit, dialogut dhe respektit të ndërsjellë.

Roli i të rinjve në këtë drejtim është thelbësor. Ata janë bartësit e së ardhmes dhe garantët e vazhdimësisë së kësaj vlere. Në Forcat e Armatosura, të rinjtë jo vetëm që trajnohen për të mbrojtur vendin, por edhe për të jetuar dhe punuar së bashku në harmoni. Përvoja e tyre në një mjedis shumëngjyrësh nga pikëpamja kulturore dhe fetare i përgatit ata për të qenë qytetarë të përgjegjshëm dhe ambasadorë të vlerave shqiptare.

Festat që afrojnë janë një moment reflektimi për të gjithë. Ato na kujtojnë rëndësinë e besimit, por edhe rëndësinë e njeriut pranë nesh. Na kujtojnë se përtej riteve dhe traditave, thelbi është i njëjtë: të jemi më të mirë, më të drejtë dhe më të bashkuar.

Në familjet shqiptare, në rrugët e qyteteve dhe fshatrave, në institucionet shtetërore dhe në repartet ushtarake, kjo frymë ndihet dhe jeton. Ajo nuk ka nevojë për shumë fjalë,

sepse shfaqet në gjeeste të thjeshta: një urim, një vizitë, një tryezë e përbashkët.

Bashkëjetesa fetare është një nga shtyllat më të forta të identitetit tonë kombëtar. Ajo është një pasuri që nuk duhet marrë si e mirëqenë, por si një përgjegjësi për t'u ruajtur dhe zhvilluar.

Në një botë që shpesh ndahet, Shqipëria ka zgjedhur të bashkojë.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron forca jonë më e madhe, në aftësinë për të qenë të ndryshëm në besim, por të njëjtë në vlera; për të festuar ndryshe, por për të jetuar së bashku.

Sepse Shqipëria nuk është thjesht një vend ku bashkëjetojnë fe të ndryshme. Ajo është një vend ku bashkëjetesa është vetë identiteti.

Në prag të festave të shënuara të Bajramit, Sulltan Nevruzit dhe Pashkëve Katolike e Ortodokse, Redaksia e Shtypit Ushtarak përcjell urimet më të sinqerta për të gjithë efektivët e Forcave të Armatosura dhe për mbarë popullin shqiptar.

Këto ditë të bekuara le të sjellin paqe, shëndet, begati dhe harmoni në çdo familje. Urojmë që fryma e besimit, sakrificës dhe solidaritetit të na bëjë më të fortë, më të bashkuar dhe më të vendosur për të përballuar çdo sfidë.

Mirënjohje e veçantë për çdo ushtarak që, edhe në ditë feste, vijon të qëndrojë në krye të detyrës, duke shërbyer me përkushtim ndaj atdheut dhe qytetarëve.

Gëzuar festat! Mbarësi, paqe dhe mirësi për të gjithë!

Arsimi si themeli i së ardhmes së shoqërisë shqiptare

Arsimi është reflektimi më i qartë i nivelit të zhvillimit të një shoqërie. Ai përfaqëson jo vetëm përgatitjen kulturore dhe profesionale të qytetarëve, por edhe mënyrën si një vend projekton të ardhmen e vet. Në Shqipëri, arsimi ka qenë gjithmonë një fushë me rëndësi të veçantë, e shoqëruar me përpjekje të vazhdueshme për përmirësim dhe përshtatje me kohën.

Në një epokë ku ndryshimet teknologjike ndodhin me ritme të shpejta dhe ku të rinjtë përballen me sfida të reja globale, arsimi mbetet një nga mjetet më të fuqishme për të ndërtuar një shoqëri të qëndrueshme, të aftë për të konkurruar dhe për të ruajtur vlerat e saj. Ai nuk është thjesht një sistem mësimor, por një proces i vazhdueshëm formimi që ndikon në çdo aspekt të jetës: nga zhvillimi personal te përfshirja aktive në komunitet.

Trashëgimia historike e arsimit shqiptar

Arsimi në Shqipëri ka kaluar nëpër faza të ndryshme. Nga periudha e Rilindjes Kombëtare, kur hapja e shkollave shqipe ishte akt patriotik, deri te tranzicioni i viteve '90, arsimi ka qenë gjithmonë i lidhur ngushtë me fatin e kombit. Shkolla ka qenë vendi ku është ruajtur gjuha, kultura dhe identiteti kombëtar. Por, ndërsa dikur arsimi shihej si mjet për mbijetesë kombëtare, sot ai duhet të shihet si mjet për zhvillim dhe integrim në botën moderne.

Teknologjia si mundësi dhe rrezik

Në dekadën e fundit, teknologjia ka hyrë fuqishëm në sistemin arsimor, duke ndryshuar mënyrën si mësohet dhe si ndërveprohet në klasë. Mësimi online gjatë pandemisë tregoi se teknologjia mund të jetë një mjet i fuqishëm për të kapërcyer kufijtë fizikë, duke lidhur nxënës e mësues në distanca të mëdha. Por ky ishte vetëm fillimi i një transformimi më të gjerë.

Sot, zhvillimet globale si inteligjenca artificiale, realiteti virtual dhe platforma interaktive digjitale po hapin horizonte të reja për arsimin. Në shumë vende, inteligjenca artificiale përdoret për të personalizuar procesin e të nxënës, duke përshtatur materialet sipas ritmit dhe nevojave të çdo nxënësi. Realiteti virtual po sjell eksperiencë të reja mësimore: nxënësit mund të "udhëtojnë" në laboratorë shkencorë, muze historikë apo madje edhe në hapësirë, pa lëvizur nga klasa. Këto inovacione po e bëjnë arsimin më të gjallë, më praktik dhe më tërheqës.

Roli i mësuesit

Në zemër të çdo sistemi arsimor që synon cilësinë dhe zhvillimin qëndron figura e mësuesit. Mësuesi nuk është thjesht një transmetues i dijes, por një udhërrëfyes, një frymëzues dhe një ndërtues karakteresh. Ai ka fuqinë të formësojë mendimin e brezave të rinj, të nxisë kuriozitetin dhe të kultivojë vlera që shoqëria ka nevojë t'i ruajë e t'i zhvillojë.

Në Shqipëri, mësuesit përballen me një realitet dinamik, ku roli i tyre po zgjerohet përtej klasës tradicionale. Ata janë gjithnjë e më të angazhuar në formimin social, emocional dhe digjital të nxënësve. Kjo kërkon jo vetëm përgatitje akademike, por edhe aftësi për të komunikuar, për të motivuar dhe për të përshtatur metodat mësimore me nevojat e kohës.

Investimi në formimin profesional të mësuesve është një hap strategjik për të ndërtuar një sistem arsimor të qëndrueshëm. Trajnimet e vazhdueshme, qasja ndaj metodave bashkëkohore dhe mbështetja institucionale janë elementë që e fuqizojnë rolin e tyre. Kur mësuesi ndjehet i vlerësuar dhe i përgatitur, ai e transmeton këtë energji te nxënësit, duke krijuar një atmosferë pozitive dhe produktive në klasë.

Një mësues i mirë nuk është vetëm ai që mëson, por ai që frymëzon. Ai është ai që sheh potencialin te çdo nxënës, që nxit pyetjet dhe jo vetëm përgjigjet, që ndihmon të rinjtë të ndërtojnë vetëbesimin dhe të kuptojnë rolin e tyre në shoqëri. Në këtë kuptim, mësuesi është një nga figurat më të rëndësishme për të ardhmen e vendit.

Rrjetet Sociale dhe Shpërqendrimi nga Vlerat e Arsimit

Formimi i brezave të rinj nuk lidhet vetëm me dijen akademike, por edhe me aftësitë praktike dhe sociale që i ndihmojnë të përballen me sfidat e jetës moderne. Sot, një nga faktorët që ndikon dukshëm në këtë proces është prania e vazhdueshme e rrjeteve sociale. Brezat e rinj janë të lidhur ngushtë me botën digjitale, ku informacioni qarkullon me shpejtësi dhe ku shpesh vëmendja shpërqendrohet nga qëllimet kryesore të arsimit.

Rrjetet sociale, me ritmin e tyre të shpejtë dhe me fokusin te imazhi apo fama e menjëhershme, shpesh e largojnë rininë nga përqendrimi në vlera të qëndrueshme si studimi i thelluar, mendimi kritik dhe ndërtimi i aftësive profesionale. Ky shpërqendrim reflektohet në mënyrën si të rinjtë e përdorin kohën e tyre, duke u fokusuar më shumë te përmbytja e momentit sesa te procesi i gjatë i formimit.

Pasojat e kësaj prirjeje shfaqen edhe në jetën sociale: të rinjtë shpesh e kanë më të vështirë të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme, të marrin përgjegjësi dhe të përfshihen në



komunitet. Kur vlerat e arsimit lihen në hije nga ndikimi i rrjeteve sociale, formimi i brezave bëhet më i fragmentuar dhe më pak i qëndrueshëm.

Shembuj nga realiteti i përditshëm

Në jetën e përditshme të rinisë, vihet re se diplomimi shpesh shoqërohet me nevojën për më shumë eksperiencë praktike. Studentët e degëve si inxhinieri, mjekësi apo shkencë sociale përfundojnë studimet me bazë teorike të fortë, por shpesh pa kontakt të mjaftueshëm me pajisje laboratorike moderne apo eksperiencë klinike të zgjeruara. Kjo krijon një hendek mes dijes së fituar dhe praktikës së nevojshme.

Po ashtu, përgatitja për tregun e punës kërkon aftësi të reja që lidhen me teknologjinë, komunikimin digjital dhe analizën e të dhënave. Ndërkohë, shumë të rinj e kalojnë një pjesë të madhe të kohës në rrjete sociale, ku shpesh krijohet iluzioni i suksesit të menjëhershëm. Ky shpërqendrim nga procesi i gjatë i studimit dhe formimit profesional e bën më të vështirë ruajtjen e fokusit te vlerat e arsimit.

Mungesa e mendimit kritik është një tjetër element që vihet re në përditshmëri. Të rinjtë shpesh përballen me vështirësi në dallimin e faktit nga opinioni dhe në ndërtimin e argumenteve të forta. Kjo reflektohet në debatet publike dhe në komunikimin e përditshëm, ku shpesh dominon retorika



e thjeshtë në vend të analizës së thelluar.

Pasojat sociale dhe psikologjike

Ndikimi i rrjeteve sociale si shpërqendrim nga vlerat e arsimit nuk reflektohet vetëm në aspektin profesional, por edhe në jetën sociale të brezave të rinj. Shumë të rinj, të përfshirë në botën digjitale, shpesh ndihen të pasigurt për të ardhmen, duke përjetuar mungesë motivimi dhe vështirësi në ruajtjen e fokusit te studimi dhe zhvillimi personal. Ky shpërqendrim krijon ndonjëherë ndjesinë e izolimit, duke e bërë më të vështirë ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe marrjen e përgjegjësi në komunitet.

Paradoksi i kohës sonë është se rinia shqiptare përgatitet me dije dhe aftësi, por shpesh e sheh arsimin si një trampolinë drejt mundësive jashtë vendit, në vend që ta përjetojë si bazë për zhvillim brenda shoqërisë. Ky fenomen tregon se formimi i brezave nuk është vetëm një proces akademik, por edhe një proces social e psikologjik, ku balanca mes dijes, aftësive praktike dhe vlerave të qëndrueshme është thelbësore për të ardhmen.

Arsimi si investim afatgjatë

Shpesh, arsimi shihet si shpenzim, jo si investim. Por, çdo shoqëri që ka investuar seriozisht në arsim ka përfituar zhvillim të qëndrueshëm. Finlanda, për shembull, është një model i qartë se si një vend i vogël mund të bëhet lider global përmes arsimit. Shqipëria duhet të ndjekë një vizion të ngjashëm: të investojë në cilësi, jo vetëm në sasi; në përmbytje, jo vetëm në infrastrukturë.

Arsimi si ura drejt së ardhmes

Arsimi është ura që lidh të tashmen me të ardhmen. Pa një sistem arsimor të fortë, çdo përparim ekonomik apo teknologjik mbetet i brishtë. Shqipëria ka nevojë për një reformë të thellë, jo vetëm në ligje dhe programe, por në mentalitetin e shoqërisë. Arsimi duhet të shihet si prioritet kombëtar, si themel mbi të cilin ndërtohet e ardhmja. Vetëm atëherë, brezat e rinj do të kenë mundësinë të ndërtojnë një shoqëri të drejtë, të zhvilluar dhe të qëndrueshme.

Sistemet antidron dhe interceptimi: Teknologjia që mbron hapësirën ajrore dhe sigurinë publike

Dronët luftarakë janë shndërruar në një nga armët më të përdorura në konfliktet moderne. Ata ofrojnë avantazhe të mëdha për ushtritë: kosto më të ulët krahasuar me avionët tradicionalë, rrezik më i vogël për pilotët, fleksibilitet në operacione dhe aftësi për të kryer sulme precize në distanca të gjata. Nga Lindja e Mesme te Europa Lindore, dronët luftarakë janë bërë pjesë e përditshme e fushëbetejës, duke ndryshuar balancat e fuqisë dhe mënyrën si konceptohet lufta.

Por ky zhvillim ka sjellë edhe një sfidë të re: si të mbrohen vendet, qytetet dhe infrastruktura kritike nga kërcënimet ajrore të dronëve. Ndryshe nga avionët e mëdhenj, dronët luftarakë janë shpesh më të vegjël, më të shpejtë dhe më të vështirë për t'u zbuluar. Ata mund të veprojnë në grupe (të ashtuquajturat "swarm drones"), duke e bërë edhe më të komplikuar mbrojtjen. Për këtë arsye, sistemet antidron dhe teknologjitë e interceptimit janë kthyer në një element thelbësor të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes moderne.

Këto sisteme nuk janë më opsion, por domosdoshmëri. Ato përfaqësojnë vijën e parë të mbrojtjes kundër një armiku që nuk vjen gjithmonë me tanke apo avionë, por me mjete të vogla, të padukshme dhe të programueshme. Në këtë kontekst, investimi në radarë të avancuar, sisteme jamming, interceptues aktivë dhe inteligjencë artificiale për analizën e sinjaleve është një kusht i pashmangshëm për çdo shtet që kërkon të mbrojë hapësirën e tij ajrore dhe sigurinë e qytetarëve.

Rritja e kërcënimeve ajrore: Pse dronët nuk janë më thjesht lodra

Dronët, dikur të konsideruar si pajisje për hobi apo filmime, kanë evoluar në mjete të sofistikuara që mund të transportojnë ngarkesa të rrezikshme, të kryejnë survejim të fshehtë dhe të ndërhyjnë në sisteme të ndjeshme. Në Shqipëri, si në shumë vende të tjera, janë raportuar raste ku dronët janë përdorur për kontrabandë në burgje, për filmime të paautorizuara në zona të ndaluara dhe për ndërhyrje në ngjarje publike.

Kërcënimet nuk kufizohen vetëm në Shqipëri. Në nivel global, dronët janë përdorur për sulme ndaj liderëve politikë, për transport të eksplozivëve në zona të luftës dhe për ndërhyrje në hapësirën ajrore civile. Kjo ka bërë që sistemet antidron të mos jenë më luks, por domosdoshmëri.

Si funksionojnë sistemet antidron: Teknologjia që sheh, ndjek dhe neutralizon

Sistemet antidron janë të ndërtuara për të zbuluar, identifikuar dhe neutralizuar dronët e paautorizuar. Ato përfshijnë një kombinim të teknologjive të avancuara, duke filluar nga radarët dhe sensorët RF që zbulojnë sinjalet ajrore, deri te kamerat termike që identifikojnë objektin në kohë reale. Pasi droni lokalizohet, sistemet jamming ndërhyjnë për të ndërprerë komunikimin mes dronit dhe operatorit, duke e detyruar atë të ulet ose të humbasë kontrollin.

Në raste më të avancuara, përdoren interceptues aktivë – dronë të specializuar që ndjekin dhe kapin dronin e rrezikshëm në ajër. Disa sisteme përfshijnë edhe armë elektromagnetike që neutralizojnë elektronikën e dronit pa dëmtuar mjedisin përreth. Inteligenca artificiale luan një rol kyç në analizimin e sjelljes së dronit dhe në vendimmarrjen për mënyrën më efikase të ndërhyrjes.

Interceptimi si mbrojtje inteligjente, më shumë se ndalim fizik

Interceptimi nuk është thjesht ndalimi i një droni në ajër. Ai përfshin një gamë të gjerë veprimesh që synojnë parandalimin e sulmeve, mbledhjen e të dhënave dhe analizën e sinjaleve të dyshimta. Teknologjitë e interceptimit përdoren për të monitoruar komunikimet, për të zbuluar sinjale të koduara dhe për të analizuar rrjetet që mund të jenë të përfshira në operacione të paligjshme.

Në kontekstin e sigurisë publike, interceptimi ndihmon në mbrojtjen e ngjarjeve të mëdha, figurave të rëndësishme dhe objekteve strategjike. Ai është një mjet i fuqishëm për të parandaluar sulme të organizuara dhe për të siguruar reagim të shpejtë në rast emergjence.

Përdorimi global dhe trendet e vitit 2026

Në vitin 2026, vendet me kapacitete të larta teknologjike si SHBA, Izraeli, Franca dhe Turqia kanë zhvilluar sisteme antidron që përdoren në aeroporte, baza ushtarake, kufij dhe qendra energjetike. Këto sisteme janë të integruara me rrjete të inteligjencës artificiale dhe me platforma të mbikëqyrjes satelitore, duke krijuar një mbrojtje të shumëfishtë.

Në Europë, gjithnjë e më shumë qytete po instalojnë sisteme antidron për mbrojtjen e ngjarjeve publike, si koncertet, ndeshjet sportive dhe tubimet politike. Kjo tregon se teknologjia nuk është më e kufizuar në fushën ushtarake, por po bëhet pjesë e sigurisë civile.



Sfida të mëdha përballë nevojës urgjente: Ku duhet të përqendrohet përmirësimi

Pavarësisht përparimeve, sfidat mbeten të shumta. Kostoja e lartë e sistemeve antidron është një pengesë për vendet me buxhete të kufizuara. Mungesa e personelit të trajnuar për operimin e këtyre sistemeve dhe për analizën e të dhënave është një tjetër problem që kërkon zgjidhje urgjente. Për më tepër, evolucioni i shpejtë i teknologjisë së dronëve kërkon përditësim të vazhdueshëm të sistemeve mbrojtëse. Dronët po bëhen më të vegjël, më të shpejtë dhe më të vështirë për t'u zbuluar. Kjo do të thotë se sistemet antidron duhet të jenë fleksibël, të adaptueshme dhe të integruara me platforma të

tjera të sigurisë. Koordinimi ndërinstitucional është gjithashtu një sfidë. Policia, ushtria, shërbimet civile dhe institucionet e inteligjencës duhet të punojnë së bashku në mënyrë të sinkronizuar për të garantuar një reagim të plotë dhe efikas.

Teknologjia që mbron të tashmen dhe parandalon të ardhmen

Sistemet antidron dhe interceptimi janë sot më shumë se pajisje teknologjike – ato janë garanci për sigurinë, për rendin dhe për mbrojtjen e jetës. Në një botë ku kërcënimet mund të vijnë nga ajri, nga sinjalet dhe nga heshtja, mbrojtja duhet të jetë aktive, inteligjente dhe e koordinuar.





Qendra e Personel Rekrutimit njofton se ka filluar regjistrimin e kandidatëve për **200 (dyqind) ushtarë/detarë aktivë**, të cilët do të shërbejnë në funksione dhe vend-dislokime sipas nevojave të Forcave të Armatosura.

Periudha e Stërvitjes

Stërvitja Individuale Bazë do të zhvillohet nga **18 maj deri më 24 korrik 2026**, në qendrat e përcaktuara të trajnimit. Kandidatët e përzgjedhur do të përgatiten për të përballuar sfidat e shërbimit aktiv dhe për të kontribuar në mbrojtjen e vendit.

Afati i Dokumentacionit

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm duhet të bëhet deri më **17 prill 2026**.